



ROUTER
TRING
WIRELESS
ADSL 2+

MANUAL INSTALIMI



Manual Instalimi

Router Tring Wireless ADSL 2+

1. Kontrolli i pjesëve përbërëse

Paketa e “Routerit Tring Wireless” duhet te përmbajë pjesët e mëposhtme:

1. Routeri Tring Wireless përbëhet nga:
 - Hyrja e ushqimit
 - Butoni i fikjes dhe i ndezjes
 - Porta DSL
 - Katër porta LAN
 - Antena e Wireless-it
2. Ushqyesi i Routerit Tring Wireless
3. Spliteri përbëhet nga:
 - Porta Line (Porta që lidhet me rrjetin Tring)
 - DSL (Porta që lidhet me Router Tring Wireless)
 - Phone (Porta që lidhet me telefonin)
4. Kabulli i telefonit (RJ-11):
 - Realizon lidhjen e spliterit me Telefonin Analog
5. Kabulli Ethernet (RJ-45):
6. CD me manualin e plotë të përdorimit në formatin PDF
7. Manuali i Instalimit

2. Paneli përpara

Paneli përpara përmban një seri dritash (LEDs) që tregojnë gjëndjen e “Routerit Tring Wireless ADSL2+”.



Fig. 1: Paraqitja balllore e “Routerit Tring Wireless ADSL 2+”

Power ON/OFF

Ngjyra	Gjendja e dritës	Funksioni
Jeshile	E qëndrueshme	Drita LED, qëndron në mënyrë të vazhdueshme jeshile në kohën kur pajisja është e ndezur dhe merr burim energjie.
E Kuqe	E qëndrueshme	Drita LED, qëndron në mënyrë të vazhdueshme e kuqe për të treguar mos funksionim normal të paisjes
OFF		Paisja është e fikur, nuk ka furnizim me Energji ose nuk është realizuar lidhja e ushqyesit me Modemin

ADSL WAN Connectivity / DSL

Ngjyra	Gjendja e dritës	Funksioni
Jeshile	E qëndrueshme	Tregon realizimin e lidhjes ADSL WAN, lidhja është stabilizuar
	Pulsuese	Lidhjes ADSL WAN është në proces
OFF		Kur drita ADSL Wan është e fikur paisja mund të jetë e fikur ose nuk është stabilizuar lidhja ADSL WAN.

Internet Connectivity

Ngjyra	Gjendja	Funksioni
Jeshile	E Qendrueshme	Lidhja WAN është stabilizuar por asnjë informacion nuk ka filluar të transferohet
	Pulsuese	Lidhja WAN është stabilizuar dhe informacion ka filluar të transferohet/ lëvizë
E kuqe	E Qendrueshme	Lidhja WAN nuk është stabilizuar
OFF		<ul style="list-style-type: none"> - Paisja është e fikur - Nuk është stabilizuar lidhja IP-Layer Connection tek ndërfaqja WAN - Paisja është konfiguruar si LAN bridge

Ethernet LAN1, LAN2, LAN3, LAN4

Ngjyra	Gjendja e dritës	Funksioni
Jeshile	E qëndrueshme	Tregon realizimin e lidhjes Ethernet (kabulli ethernet është i lidhur nga njëra ana me PC dhe në anën tjetër me Modemin)
	Pulsuese	Tregon që në porten Ethernet kalon trafik
OFF		<ul style="list-style-type: none"> - Paisja është e fikur - Nuk është stabilizuar lidhja Ethernet (PC – Modem)

WLAN Connectivity

Ngjyra	Gjendja e dritës	Funksioni
Jeshile	E qëndrueshme	Tregon realizimin e lidhjes WLAN, por nuk ka trafik në link
	Pulsuese	Tregon realizimin e lidhjes WLAN, dhe në link është duke kaluar trafik
OFF		<ul style="list-style-type: none"> - Paisja është e fikur - Nuk është stabilizuar lidhja WLAN

3. Paneli i Pasëm

Paneli i pasëm tregon portat e ndryshme lidhese që janë prezente në pjesën e prapme të "Routerit Tring Wireless ADSL 2+" që ju do të dispononi. Ju rekomandojmë që ti rishikoni me imtësi këto pjesë para se te filloni me procesin e instalimit. Vini re se ngjyra e portave ju ndihmon gjatë procesit të instalimit. Gjithashtu duhet te keni parasysh që diagrama e meposhtme mund të mos i korrespondoje plotesisht pajisjes qe ju keni ne kuti për arsye te pjesëve shtesë te cilat janë përfshirë në manual.



Fig. 2: Paneli i Pasëm i "Routerit Tring Wireless ADSL 2+"

Përshkrimi	Funksioni
Antena Ëireless	Një antenë e jashtme për një kapje sa më të mirë të sinjalit Wireless në rrjetin tuaj LAN (present vetëm në modelet qe jane te pajisur me WiFi)
Çelësi On/Off	Çelësi kryesor i pajisjes. Ju lutemi të siguroheni që është në pozicionin "Off" para se të filloni procedurën e instalimit.
Porta e Energjisë	Këtu ju do lidhni adaptorin e energjisë. Ju lutemi të përdorni vetëm adaptorin që shoqëron pajisjen në kuti. Kujdes: Nëse përdorni një adaptor energjie me një tjetër vlerë voltazhi do të dëmtoni pajisjen tuaj.
Portat Ethernet (e verdhe)	Këto 4 Porta LAN (Local Area Network) mund të përdoren për të lidhur kompjuterin tuaj me kabullin e verdhë Ethernet i cili ndodhet në kutinë e paisjes. Ju mund ti përdorni gjithashtu për të lidhur paisje rrjeti të tjera si switch dhe hub-e. Keto porta janë Auto-MDIX dhe të gjitha paisjet që do të lidhim, mund te perdoret kabëll rrjeti të drejtë.
Porta DSL (Gri)	Kjo portë lidh "Routerit Tring Wireless" me linjën kryesore të Tring Communications. Përdorni kabullin e telefonit RJ11 i cili shoqëron paisjen.
Butoni Reset	Nëse e mbani të shtypur për më shumë se 5 sekonda, modemit do ti fshihet konfigurimi. Është e ndaluar të shtypet ky buton pa rekomandimin e Suportit te Tring Communications.

4. Procedura e Instalimit

4.1 Lidhja me rrjetin ADSL

Lidhni kabullin e zi të telefonit që shoqëron pajisjen në kuti në portën e shënuar “DSL” tek “Routeri Tring Wireless ADSL 2+ “ dhe nga ana tjetër lidhjeni kabllin tek priza ku vjen linja juaj telefonike, e cila ka dhe shërbimin DSL të aktivizuar nga Tring Communication.



Fig. 3: Tabloja e Lidhjes së Paisjeve

4.2 Ndezja e “Routerit Tring Wireless ADSL 2+”

Verifikoni që në Routerin Tring Wireless ADSL 2+, Wireless-i -i është i aktivizuar. Vendosni adaptorin e energjisë në portën Power të “Routerit Tring Wireless ADSL 2+” dhe më pas lidhjeni me prizën e energjisë.

Ndizeni pajisjen tuaj “Routerin Tring Wireless ADSL 2+” dhe në këtë moment të gjitha dritat në pjesën e përparme duhet të ndizen për një kohë të shkurtër dhe drita Power duhet të qëndrojë jeshile gjatë gjithë kohës.

5. Lidhja me Kompjuterin / Laptopin

5.1 Opsioni 1, Lidhja nëpërmjet kabullit Ethernet

Krijoni lidhjen e kabullit Ethernet që shoqëron paisjen në kuti me njërën prej 4 portave të verdha Ethernet të “Routerit Tring Wireless ADSL 2+”
Krijoni lidhjen e anës tjetër të kabullit në portën Ethernet të kompjuterit tuaj.
Verifikoni që drita Ethernet në pjesën e pasme të “Routerit Tring Wireless ADSL 2+”, që i korrespondon numrit të portës Ethernet, është në përdorim e ndezur ose po pulson.

5.2 Opsioni 2, Lidhja me Wireless

Ndriqni manualin e instalimit të adaptorit Wireless (kartës Wireless të kompjuterit ose adaptorit Wireless USB) për të instaluar driver-at dhe programet përkatëse.
Paisja juaj e “Routerit Tring Wireless” ka këto parametra fillestare për të siguruar rrjetin Wireless:
Network Mode: Infrastructure
SSID: TRING -xxxxx, (xxxxx janë 5 shifrat e fundit të S/N. (SSID-ja e veçantë për çdo paisje, është e printuar në fund të shënimit)
Encryption: WPA(2)-PSK
WPA Key: E veçantë për çdo paisje. E printuar në shënimin e vendosur poshtë paisjes tuaj “Routeri Tring Wireless ADSL 2+”.

5.3 Instalimi i Spliter-it

Kini parasysh që do keni nevojë për një micro-filter/ spliter për çdo paisje telefonie në shtëpinë tuaj. Këta filtra / spliterat sigurojnë që sinjali ADSL të mos interferojë me sinjalin e telefonisë në kohën kur përdoren në të njëjtën kohë. Të gjithë telefonat, fax-et sistemet e sigurisë, që përfundojnë të lidhur në të njëjtën linjë telefonie në të cilën është edhe linja ADSL do kenë nevojë për një filter ndërmjet linjës dhe paisjes. Sigurohuni që të vendosni filtrin në prizën në mur dhe më pas të lidhni në të edhe paisjen tuaj analoge brënda shtëpisë.
Mos e përdorni këtë filter ndërmjet prizës në mur dhe “Routerit Tring Wireless”.
Filtroni vetëm paisjet e sipër-përmendura.

Në Raste Problemesh

Kur të gjitha dritat në Routerin Tring nuk ndizen

Kontrolloni nëse:

Router-i është i lidhur me ushqyesin e energjisë dhe ushqyesi merr energjinë e nevojshme sipas kërkesave teknike të specifikuara. Kontrolloni nëse çelësi mbrapa paisjes është aktive, në gjendjen ON

Kur drita "Ethernet" është e fikur

Kontrolloni nëse:

Kabulli Ethernet është i lidhur në një nga portat e Lan-it ne Router në njërën anë, dhe tek kompjuteri juaj në anën tjetër

Kontrolloni nëse jeni duke përdorur kabullin e saktë për këtë lidhje i cili është UTP Cat5 me konektorë RJ-45

Kur drita "Internet" është e fikur

Kontrolloni nëse:

Kabulli DSL është i lidhur në mënyrën e duhur në portën DSL të router-it

Nuk keni vendosur filtrin ndërmjet prizës në mur ku vjen linja telefonike dhe modemit tuaj ndiqni lidhjen sipas figurës 2

Ju jeni duke përdorur kabullin origjinal të telefonisë që shoqëron paisjen Tring

Nuk lidheni me Wireless

Kontrolloni nëse:

Sigurohuni që Wireless-i është konfiguruar në rregull tek (Wireless Settings)

Kontrolloni sinjalin nga treguesi i sinjalit në paisjen tuaj nëse është i ulët përpikuni të drejtoni antenën në Router sipas drejtimit ku ndodhet paisja që do te lidhet (Laptop, Smartphone etj)

Sigurohuni që adaptor Wireless i paisjes së klientit është i aktivizuar

Nëse përsëri keni sinjal të dobët :

Ndryshoni kanalin e Wireless-it tek Wireless settings

Përdorni enkriptimin WPA (2)-PSK për sigurinë e rrjetit Wireless

**ROUTER
TRING
WIRELESS
ADSL 2+**

Kompleksi "Don Bosko",
Kulla VII, Kati II,
Tiranë, Albania

T: +355 44 800 000

F: +355 44 800 001

E: info@tring.al

www.tring.al